

KQZ  
U PROTOKOLLUA  
NR. 574/4 PROT  
DATE 16 10 2017

**PARTIA SOCIAL DEMOKRATE**

---

**Raporti i Ekspertit Kontabel te Rregjistruar**

**Per Fondet e Perfituar dhe te Shpenzuara**

**Gjate vitit 2016**

**(Ushtrimi i Mbyllur 31.12.2016 )**

**PËRMBAJTJA**

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E BURIMEVE TE FONDEVE

PASQYRA E PËRDORIMEVE TË  
FONDEVE

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

## RAPORT AUDITIMI

### **PER AUDITIMIN E FONDEVE TE PERFITUARA DHE TE SHPENZUARA PER VITIN 2016 NGA "PARTIA SOCIAL DEMOKRATE"**

**Drejtuar :**

*Partise Social Demokrate*

*Rruga Hoxha Tasim Nr /26*

*TIRANE*

*Komisionit Qendror te Zgjedhjeve*

*Bulevardi "Gjergj Fishta"*

*TIRANE*

Ne zbatim te vendimit nr. 196, date 03.05.2017 te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve si dhe bazuar ne Ligjin 10019 date 29/12/2008 "Kodi zgjedhor i Republikes se Shqipërisë" I ndryshuar , si dhe ne kontraten e sherbimit te lidhur me KQZ me cilesine e ekspertes kontabile te regjistruar une jam emeruar per te bere auditimin e fondeve te perfituar dhe te shpenzuara per vitin ushtrimor 2016 per subjektin "Partia Social Demokrate", qe perfshin bilancin kontabet, pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve si dhe nje permbledhje te politikave kontabile kryesore si dhe shpjegime te tjera.

#### **Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare**

Drejtimi ( PSD ) eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit , sic kerkohet edhe nga ligji nr. 9228 "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" ,dhe per ato kontrole te brendshme, qe drejtimi e konsideron te nevojshme per te bere te mundur pergatitjen e pasqyrave financiare qe nuk permbajne anomali materiale, per shkak te mashtrimit apo gabimit.

#### **Pergjegjesia e Audituesve**

Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare bazuar ne auditimin e kryer nga ana jone. Ne kemi kryer auditimin ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

Keto Standarte kerkojne qe ne te respektojme kerkesat etike dhe te planifikojme dhe kryejme auditimin per te arritur sigurine e arsyeshme se pasqyrat financiare nuk permbajne anomali materiale .

Nje auditim perfshin kryerjen e procedurave per te siguruar evidencen e nevojshme te auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese te dhena ne pasqyrat

financiare. Procedurat e zgjedhura jane ne varesi te gjykimit te audituesit, perfshire ketu vleresimin e rreziqeve te anomalise materiale ne pasqyrat financiare, te cilat mund te vijne si pasoje e mashtrimit apo gabimit. Ne vleresimin e ketyre rreziqeve, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem te entitetit qe ka te beje me pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare me qellim qe te percaktoje procedura auditimi qe jane te pershtatshme per rrethanat, por jo per qellime te shprehjes se nje opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit te brendshem te entitetit.

Nje auditim perfshin gjithashtu, vlersimin e pershtatmerise se politikave kontabel te perdorura, te arsyeshmerise se cmuarjeve kontabel te bera nga drejtimi, si edhe vlersimin per paraqitjen e pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe kemi siguruar eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te sherbyer si baze per opinionin tone te auditimit.

### **Opinionimi**

Sipas opinionit tone, Pasqyrat Financiare , paraqesin një pamje të vërtetë e të sinqertë të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga " Partia Socialdemokrate e Shqiperise" per periudhen ushtrimore 1 janar deri me 31 dhjetor 2016 në përputhje me Ligjin 8580 datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike" i ndryshuar, Ligjin 9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"dhe Standartet kombetare te kontabilitetit.

**Ekspert Kontabel i Regjistruar**

**Vullnetare Cela**

Rr. "Tish Daija " , Kompleksi i Ri Kika , Tirane

Nr.kontakti 068 20 87 442.

**Tirane me 10.10.2017**

## PARTIA SOCIAL DEMOKRATE

## PASQYRA E FONDEVE TE PERFITURA GJATE VITIT 2016

Të Ardhurat e Perfituara			
	VITI 2016	VITI 2015	NDRYSHIMI
Gjendje 31/12/2015	633,339		633,339
Financim nga buxheti shtetit 2016	3,166,667	5,403,338	(2,236,671)
Kthim ne buxhetin e shtetit		(1,539,930)	1,539,930
<b>TOTALI</b>	<b>3,800,006</b>	<b>3,863,408</b>	<b>(63,402)</b>

## PASQYRA E FONDEVE TE PERDORURA GJATE VITIT 2016

Emertimi i shpenzimeve			
	VITI 2016	VITI 2015	NDRYSHIMI
Shpenzime paga honorare	1,296,213	1,614,072	(317,859)
Shpenzime kontributi sig shoqerore viti 2016	124,735	114,298	10,437
Shpenzime blerje karburanti	245,000	346,640	(101,640)
Shpenzime per energjine elektrike	26,757	253,965	(227,208)
Shpenzime te ndryshme	38,708	198,306	(159,598)
Shpenzime pagese auditi	54,000		54,000
Shpenzime mirembajtje godine	59,500		59,500
Shpenzime avokati	120,000	399,000	(279,000)
Shperblime punonjesish	175,000		175,000
Komisione bankare	2,850		2,850
Shpenzime per fushaten ne rrethe		685,000	(685,000)
Shpenzime promocinale		15,000	(15,000)
<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>2,142,763</b>	<b>3,626,281</b>	<b>(1,483,518)</b>

**PARTIA SOCIALDEMOKRATE E SHQIPERISE**

**PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË GJATE VITIT 2016**

LIKUIDITETE	
	Leke
Gjendje me 1.01.2016	
	633,339
Hyrje likuiditete gjate vitit	
	3,166,667
Dalje likuiditete gjate vitit	
	2,142,764
Gjendje me 31.12.2016	
	1,657,242

## **Informacion i përgjithshëm**

### **Baza Ligjore per kryerjen e ketij misioni :**

1. Ligji nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjin nr.10374 date 10.02.2011
2. Ligji nr. 10091, datë 05.03.2009 " Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar",
3. Standartet Ndërkombëtare të Auditimit dhe kryesisht SNA 800;
4. Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare";
5. Çdo dokument ligjor të marrë pranë Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë.

### **1-Të përgjithshme.**

Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, sipas dokumentacionit të Zyrës së Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton e regjistruar me urdhër nr.30/1, datë 23.04.1991, të Ministrit të Drejtësisë. Sipas ketij vendimi, është miratuar krijimi i Partisë, "Partia Socialdemokrate ", me initiale "PSD" . Kryetar i saj, është **Zoti Skender Gjinushi**.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave te Ligjit nr. 8580 , dt.17.02.2000 "Per Partite Politike", Ligjit nr. 8788, dt. 07.05.2001 "Per Organizatat Jofitimpruese" , Ligjit 8779, dt. 07.05.2001 "Per Regjistrimin e Organizatave Jofitimpruese ", nga Statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi. Selia e partise SD eshte ne rrugen "Asim Vokshi" nr 26, Tirane.

**Qëllimi i krijimit:** Qëllimi dhe objektivat e Partisë Socialiste të Shqipërisë janë të përcaktuara në programin dhe Statutin e saj.

### **Organizimi dhe drejtimi**

Organet drejtuese ne udheheqjen qendrore të PSD janë:

- Kuvendi i Partisë;
- Keshilli Kombëtare;
- Kryetari i Partise
- Kryesia e Partisë.
- Sekretari i pegjthshem

### **Burimet financiare të Partisë janë:**

- Të ardhurat nga kuotacionet;
- Të ardhurat nga buxheti i shtetit, në përputhje me legjislacionin për financimin e partive politike
- Ndihamat dhe dhurata e anëtarësisë dhe të përkrahësve të PSD sipas ligjit per partite politike.
- Çdo e ardhur tjetër që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin për financimin e partive politike.

## **SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE**

### ***PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE E RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL***

#### **Mënyra e Prëgatitjes së Pasqyrave Financiare.**

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Partia ka ndërtuar një plan të llogarive vetjake, në përputhje të plotë me Planin Unik Kontabël të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kontabiliteti është ndërtuar mbi bazën e parimeve të konstatimit. Sipas kësaj mënyre, fondet e përfituara në të holla, janë regjistruar në momentin e arkëtimit të tyre dhe fondet e përfituara në natyrë dhe shërbimet në momentin e kryerjes, duke i konvertuar në lekë me çmimin e tregut dhe shpenzimet janë pasqyruar në momentin e konstatimit të tyre kur janë kryer.

Administrimi i fondeve të përfituara dhe shpenzimet e kryera, janë të përqëndruara, në Seline e Partisë Socialdemokrate, në Qendër.

Deget financiare në rrethe kanë marrë nga selia qendrore fondet e destinuar për fushtatën zgjedhore.

#### **Mjetet monetare**

Gjendjet e likuiditeteve përfshijnë gjendjet e parave në arkë dhe në llogaritë rrjedhëse në bankë në lekë.

#### **Monedha e raportuar.**

Si monedhë bazë raportimi është përdorur monedha kombëtare, Lekë. Fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera, janë mbartur në dokumentacionin fillestar në monedhë Lekë.

Fondet dhe shpenzimet e emëtuara në monedha të huaja, janë konvertuar në Lekë, bazuar në kursin e këmbim të datës që është kryer transaksioni

Pasqyrat e paraqitura në raport janë shprehur në monedhën vendase në Lekë

#### **Taksat dhe kontributet**

Partia Socialdemokrate është organizatë jofitimprurës. Si i tillë, Partia nuk paguan tatim mbi fitimin. Partia i ka shlyer detyrimet që lindin për sig shoqërore dhe shëndetsore të punonjësve (derdhur kontribut vullnetar). Partia nuk ka respektuar dispozitat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë" në lidhje me tatimin në burim.

#### **Teprica dhe defiçiti i burimeve (te ardhurave)**

Teprica / defiçiti midis burimeve dhe përdorimeve, që krijohet gjatë vitit, pasqyrohet në pasurinë neto ose kapitalet e veta.

Të ardhurat janë të pasqyruara mbi bazën e arkëtimit të burimeve të financimit të vëna në dispozicion të Partisë.

Shpenzimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazën e faturave tatimore, mandat arkimëve dhe mandat pagesave dhe dokumentave orgjinale kontabël.



Të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen ne monedhen kombetare ne leke .  
 Per te dale ne konkluzione sa me te sakta auditori, ne kuadrin konceptual te te ardhurave dhe shpenzimeve, mori ne konsiderate ngjarje dhe fakte ekonomike financiare qe i takojne gjithe periudhes ushtrimore, 1 janar deri me 31 dhjetor 2016. Auditimi i situates financiare mori per baze gjitha dokumentacionin kontabel te mbajtur dhe raportuar gjate dhe ne fund te vitit 2016, rregjistrat kontabel si dhe gjithe dokumentacionin e nevojshem manual , gje qe mundesoi dhe krijimin e opinionit te Audituesit te Pavarur .

#### **Mjetet monetare ne banke dhe arke .**

Gjëndjet e mjetet monetare në bankë dhe arkë, në lekë në datat 31 Dhjetor 2016 dhe 31 Dhjetor 2015 janë si më poshtë:

	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2016	Ushtrimi i mbyllur 31.12.2015	NDRYSHIMI
Banka	1,136,279	126,463	1,009,816
Arka	520,963	506,876	14,087
<b>TOTALI</b>	<b>1,657,242</b>	<b>633,339</b>	<b>1,023,903</b>

Gjëndjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat janë të njëjta me të dhënat e llogarive rrjedhëse dhe konfirmohen nga nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventarët fizikë të monedhes ne leke.

U kontrolluan veprimet e kryera në arkë dhe bankë, e u konstatuan se veprimet në librat e llogarive dhe në ditarët përkatës ishin kryer sipas rregullave kontabël.

#### **Burimi i vetem i te ardhurave i Partia Socialdemokrate eshte Fondi publik (financuar nga buxheti, KQZ).**

Partia Socialdemokrate ka celur llogari bankare prane Bankes Kombtare Tregtare me nr.110000794 ne leke.

Financimet e fondeve nga buxheti i shtetit jane bere ne banka kombtare tregtare si me poshte :

Shuma 3.166,667 leke eshte derdhur me date 20.05.2016 sipas shkrese se MF .

Nga auditimi vihet re se shume veprime behen ne arken e parties me leke ne dore dhe rekomandojme qe veprimet te kryhen ne banke.

#### **Te ardhura nga donacionet.**

Gjate vitit 2016, gjate kryerjes se auditimit nuk kam konstatuar te ardhura nga donacionet ne para apo ne natyre.

Per vitin 2016 Partia Social Demokrtae nuk ka perfituar te ardhura nga kuotat e antaresimit dhe as nuk ka marre kredi apo garanci te ndryshme nga bankat dhe instutucionet e tjera te financiare apo nga te tretet.

## SHPENZIMET E KRYERA GJATE VITIT 2016

Emertimi i shpenzimeve	VITI 2016	VITI 2015	NDRYSHIMI
Shpenzime paga honorare	1,296,213	1,614,072	(317,859)
Shpenzime kontributi sig shoqerore viti 2016	124,735	114,298	10,437
Shpenzime blerje karburanti	245,000	346,640	(101,640)
Shpenzime per energjine elektrike	26,757	253,965	(227,208)
Shpenzime te ndryshme	38,708	198,306	(159,598)
Shpenzime pagese auditi	54,000		54,000
Shpenzime mirembajtje godine	59,500		59,500
Shpenzime avokati	120,000	399,000	(279,000)
Shperblime punonjesish	175,000		175,000
Komisione bankare	2,850		2,850
Shpenzime per fushaten ne rrethe		685,000	(685,000)
Shpenzime promovionale		15,000	(15,000)
<b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>	<b>2,142,763</b>	<b>3,626,281</b>	<b>(1,483,518)</b>

Per vitin 2016 totali i shpenzimeve te vitit 2016 ne krahasim me vitin 2015 eshte ulur me 1,483,518 leke.

U krye verifikimi dhe kontrolli i plote i shpenzimeve te mesiperme. Shpenzimet e kryera jane pasqyruar mbi bazën e faturave tatimore me tvsh, faturave tatimore te thjeshta, kuponave tatimore, mandat arketimëve te institucioneve buxhetore dhe mandat pagesave. Faturat e nje pjese te shpenzimeve te kryera jane kupon kase dhe jo me fature te rregullt tatimore ne kundërshtim me ligjin :Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Rekomandojme qe ne te ardhmen te gjitha shpenzimet te jene te dokumentura me fatura te rregullta tatimore sipas ligjleslacionit fiscal.

Auditimi i shpenzimeve u realizua ne analize te tyre ne krahasim me dokumentin justifikues te paraqitur nga subjekti.

Pjesa me e madhe e shpenzimet janë paguar nga arka dhe jo nëpërmjet llogarisë bankare. Nuk ka raste qe shumat e shpenzimeve te paguara nga arka te kalojne kufirin i vënë nga organet fiskale .

Rekomandoj që në të ardhmen veprimet të kryhen nëpërmjet llogarisë bankare.

Tirane, me 10.10.2017